
BASHKIMI EVROPIAN – SHQIPËRI
NËNKOMITETI I 13-të
DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA
9 - 10 DHJETOR 2021

Takimi i 13-të i Nënkomisionit për Drejtësi, Liri dhe Siguri ndërmjet BE-së dhe Shqipërisë u zhvillua në datat 9 dhe 10 dhjetor 2021. Përfaqësues nga Komisioni Evropian dhe autoritetet shqiptare diskutuan mbi zhvillimet më të fundit në fushën e reformës në drejtësi, antikorrupsionit, të drejtave themelore, azilit dhe migrimit, luftës kundër krimit të organizuar, luftës kundër pastrimit të parave dhe kundërterrorizmit. Takimi u bashkëkryesua nga znj. Michela Matuella, shefe e Njësisë për Shqipërinë dhe Maqedoninë e Veriut në Drejtorinë e Përgjithshme për Politikën Evropiane të Fqinjësisë dhe Negociatat e Zgjerimit të Komisionit Evropian (Komisioni) dhe znj. Adea Pirdeni, zëvendësministre e Drejtësisë.

Komisioni përshëndeti progresin e mirë dhe rezultatet konkrete në zbatimin e reformës në drejtësi pavarësisht situatës të shkaktuar nga pandemia. Gjithashtu, nënvizoi rëndësinë e zgjatjes në kohë të mandatit të organeve të Vetting-ut, në përputhje me opinionin e Komisionit të Venecias, i cili është thelbësor për qëndrueshmërinë dhe integritetin e procesit. Komisioni përshëndeti rezultatet e para konkrete të organeve të specializuara për luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ai vlerësoi gjithashtu përparimin e arritur në fusha të tjera kyçe të reformës në drejtësi.

Komisioni theksoi nevojën për përpjekje të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, veçanërisht në nivel të lartë si dhe vuri në dukje nevojën për një fokus të vazhdueshëm për të trajtuar rekomandimet e pa zbatuara të GRECO-s. Për sa i përket të drejtave themelore, Komisioni përshëndeti zbatimin e ligjit për finalizimin e proceseve kalimtare të pronësisë. Ai gjithashtu bëri thirrje për konsultimet e duhura, pasuar nga miratimi i shpejtë i legjislacionit dytësor të mbetur për mbrojtjen e pakicave kombëtare. Komisioni ngriti rëndësinë e rifillimit të progresit në lidhje me lirinë e shprehjes, garantimit të qasjes së drejtpërdrejtë dhe transparente të medias në institucionet qeveritare, si dhe pavarësinë dhe legjitimitetin e autoritetit rregullator audio-vizive në kontekstin e emërimeve në vazhdim.

Në fushën e punëve të brendshme, Komisioni përshëndeti rritjen e angazhimit dhe bashkëpunimin operativ me agjencitë e BE-së dhe shtetet anëtare të BE-së, si dhe zbatimin e mirë të Planit të Përbashkët të Veprimit për kundërterrorizmin. Shqipëria duhet të finalizojë zbatimin e planit të veprimit të Task Forcës së Veprimit Financiar (FATF). Gjithashtu, vlerësoi përpjekjet e vazhdueshme të Shqipërisë në luftën kundër kultivimit dhe trafikimit të kanabisit.

Komisioni përshëndeti miratimin e ligjit të ri për azilin dhe shumicën e legjislacionit të tij dytësor, duke vënë në dukje nevojën për zbatimin efektiv të tij. Autoritetet shqiptare do të bëjnë përpjekje të vazhdueshme për të trajtuar kërkesat e pabazuara për azil të shtetasve shqiptarë në vendet anëtare të BE-së dhe vendet e asociuara me hapsirën Shengen si dhe përshëndeti përpjekjet për të përmirësuar bashkëpunimin dhe për të dhënë rezultate të prekshme me vendet më të prekura të BE-së. Shqipëria vazhdon të përmbushë kërkesat për liberalizimin e vizave dhe ka bërë progres në trajtimin e rekomandimeve të vitit të kaluar. Politika e vizave e Shqipërisë mbetet për t'u përafëruar me *acquis* e BE-së.